



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 29
Prishtinë, më 20 korrik 2016, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala S-2

P r o c e s v e r b a l

i mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Qerim Bajrami, Blerta Deliu-Kodra, Elmi Reçica, Ismet Beqiri, Puhie Demaku dhe Zafir Berisha.

Mungoi: Teuta Rugova.

Në mbledhje ishin të pranishëm nga Universiteti i Iowa-së, dekanë prof. dr. Adrien Wing dhe ligjëruesi prof. Nathan Miller.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Qerim Bajrami, nënkryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

Takimi i përbashkët i Komisionit me dekanen, prof. dr. Adrien Wing dhe ligjëruesin prof. Nathan Miller nga Universiteti i Iowa-së.

Qerim Bajrami i dëshiroi mirëseardhje delegacionit nga Universiteti i Iowa-së dhe i njoftoi se në mungesë të kryetarit të Komisionit, i cili është në procedurë të emërimit, kryeson këtë takim të Komisionit. Bëri të ditur se komisionet parlamentare përbëhen edhe nga komunitetet e tjera dhe se në komisione i gëzojnë të drejtën e komunikimit në gjuhën e tyre. Ai i prezantoi anëtarët e Komisionit dhe i njoftoi për kompetencat e Komisionit për Punë të Jashtme duke theksuar se është një Komision i rëndësishëm në Kuvend. Duke vlerësuar përvojën akademike e profesionale të delegacionit nga Universiteti i Iowa-së dhe kontributin e tyre në shumë vende tha se eksperiencia e tyre do të jetë e mirëseardhur dhe do t'i ndihmojë shtetit tonë, si në aspektin ligjor e arsimor, ashtu edhe në atë të integriteteve në struktura ndërkombëtare.

Adrien Wing e falënderoi Komisionin për pritjen e organizuar dhe i përcolli përshëndetjet nga presidenti i Universitetit të Iowa-së, z. Bruce Harreld dhe nga dekani, drejtimi i juridikut, z. Gail

Agrawal. Njoftoi se është asistente-dekane, përgjegjëse për të gjitha programet ndërkombëtare dhe anëtare e fakultetit për 35 vjet. Më tej shtoi se ka ndihmuar në hartimin e Kushtetutës së Afrikës së Jugut, Ligjin Parimor të Palestinës dhe të Ruandës.

Sa i përket bashkëpunimit me Kosovën njoftoi se janë nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe se kanë qenë të kyçur në bashkëpunimin aktiv ndërmjet Fakultetit të Juridikut dhe ministrisë.

Po ashtu njoftoi se do të takohen me Dekanin e Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës, me të cilin do të vendosin marrëdhënie në nivel më të gjerë.

Znj. Wing tha se ne jemi të përgatitur të dëgjojmë nga ju, mënyra se si mund të bashkëpunojmë dhe se cilat janë prioritetet e juaja në këtë moment.

Nathan Miller tha se është drejtor i Klinikës Ndërkombëtare të Juridikut, në kuadër të Universitetit të Iowa-së dhe është asistent-drejtor i Qendrës së Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut në kuadër të universitetit. Njoftoi se ka ndihmuar në hartimin e Kushtetutës së Sudanit Jugor dhe se ka punuar në Palestinë, Liberi, Malavi etj.

Shprehu kënaqësinë që dy vjetët e fundit me studentët e universitetit, punon drejtpërdrejt me MPJ-në e Kosovës dhe i ofrojnë atyre analiza ligjore për një numër çështjesh lidhur me përpjekjet e vazhdueshme të Kosovës për avancim dhe bashkëpunim ndërkombëtar.

Z. Miller tha se jemi të gatshëm ta mbështesim jo vetëm ministrinë, por edhe të punojmë me çfarëdo komponentë tjetër të qeverisë, apo shoqërisë së Kosovës që mund të përfitojnë nga punët dhe analizat, të cilat ne i afrojmë. Kërkoi nga anëtarët e Komisionit se nëse kanë ndonjë mendim apo kërkesë në këtë drejtim janë të interesuar ta dëgjojnë.

Njoftoj se Qendra për të Drejtat e Njeriut do ta mbajë një konferencë për vetëvendosjen bashkëkohore, ku i pranishëm do të jetë një panel akademik dhe do të ketë një numër të aktiviteteve të ndryshme lidhur me Kosovën. Në këtë konferencë fjalën hyrëse njoftoi se do ta ketë ministri i Punëve të Jashtme i Kosovës.

Puhie Demaku falënderoi delegacionin për vizitën dhe interesin e treguar për Komisionin dhe për mundësinë e diskutimit për bashkëpunim ndërmjet Universitetit të Iowa-së dhe Komisionit.

Shprehu mendimin se njëri nga aspektet ku nuk është punuar mjaft, është diplomacia parlamentare dhe ndoshta në këtë drejtim do të mund të shihet se cilat janë mundësitë e bashkëpunimit dhe se si mund të përforcohet roli i parlamentit në punët e jashtme.

Përveç diplomacisë parlamentare, kërkoi mundësi që për stafin teknik të parlamentit, i cili ka mungesë të kapaciteteve të shikohet mundësia e bashkëpunimit në këtë drejtim, sepse kemi mangësi të njohurive të caktuara dhe ekspertiza në fusha të caktuara.

Lidhur me konferencën, e cila do të mbahet në tetor për vetëvendosjen tha se, përfaqëson partinë politike, e cila quhet Lëvizja Vetëvendosje. Në këtë konferencë ku fjalën hyrëse do ta ketë ministri i Punëve të Jashtme, tha se do të ishte mirë nëse do të ishte i pranishëm ndonjë anëtar nga Lëvizja Vetëvendosje që të japë kontributin e tij.

Blerta Deliu-Kodra theksoi se ndihet mirë që kemi në vizitë delegacionin nga Universiteti i Iowa-së, të cilët kanë një CV shumë të begatë. Duke theksuar se Kosova ka hapur një zyrë diplomatike në Iowa tha se do t'i kontribuojë në masë të madhe bashkëpunimit në mes të dy vendeve me theks të veçantë në këmbimet akademike e të studentëve. Po ashtu potencoi se Kosova ka përfituar nga programi i USAID-it, bursa për studentë dhe shumë studentë tanë kanë arritur që të studiojnë atje dhe të kthehen e të punojnë në Kosovë. Kosova pos diplomacisë parlamentare ka nevojë që të përfitojë shumë në sistemin arsimor, veçanërisht në çështjet e drejtësisë dhe ligjshmërisë sepse synimi ynë është vazhdimi i sundimit të ligjit dhe rendit demokratik. Ajo bëri të ditur se kryeson Grupin e grave deputete të Kuvendit të Kosovës dhe prej temave kryesore që janë trajtuar ka qenë

edhe çështja e grave të dhunuara gjatë luftës, çështje për të cilën tha se tani ekziston ligji dhe po punohet nga Qeveria që ato t'i gëzojnë të drejtat e tyre me këtë ligj. Theksoi se kemi nevojë nga të gjithë miqtë tanë që këtë çështje ta ngrehim në nivel ndërkombëtar, që të kërkohej drejtësi ndërkombëtare meqë ende nuk kemi asnjë të dënuar për këtë krim që është kryer në Kosovë.

Zafir Berisha takimi me delegacionin nga Universiteti i Iowa-së, tha se është kënaqësi duke pasur parasysh kontributin e madh që dhanë SHBA-të në rrugëtimin e shtet gjatë ndërtimit të Kosovës. Universiteti i Iowa-së, mund të japë një kontribut të jashtëzakonshëm në ngritjen e kapaciteteve të shkollimit të rinjve tanë përmes bursave e seminareve për studentë, meqë është në interes të vendit që shkollimi i të rinjve tanë të jetë perëndimor. Po ashtu falënderoi shtetin e Iowa-së në ndihmën të cilën ja ka ofruar Kosovës në ngritjen e kapaciteteve ushtarake, për çka theksoi se vendi ynë ka nevojë për ndihmë në këtë drejtim.

Elmi Reçica mes tjerash tha se është nder dhe respekt për ne që shteti i Iowa-së është përcaktuar qartë për ta mbështetur Kosovën, Ministrinë e Punëve të Jashtme e Komisionin. Theksoi se jemi falënderues për SHBA-të për kontributin e saj të dhënë për pavarësinë e Kosovës, në mbështetje të zhvillimit ekonomik, njohjeve dhe bashkëpunimin ndërkombëtar. Shteti i Iowa-së e ka dëshmuar që është përcaktuar ta mbështesë fuqishëm Kosovën në të gjitha segmentet ku Kosova ka nevojë, që ta fuqizojë shtetësinë e saj. Garda Kombëtare e shtetit të Iowa-së, ka dhënë një kontribut të fuqishëm për forcimin e ushtrisë sonë. Ne, si Komision, është e nevojshme të mbështesim të gjitha proceset dhe zhvillimet që janë në interes të Kuvendit të Kosovës, diplomacinë parlamentare dhe çdo gjë që ngërthehet brenda për brenda saj dhe që është domosdoshmëri e kohës. Jo vetëm për bashkëpunimin parlamentar dhe atë të komisioneve simotra, por ne kemi nevojë edhe për zhvillim ekonomik, dhe shkëmbime kulturore e arsimore, si dhe të mbështetet Komisioni ynë në të gjitha mekanizmat ku nuk është prezent Kosova, tha z. Reçica. Theksoi se me rastin e ditës së pavarësisë së SHBA-së, në Ambasadën Amerikane në Kosovë, senatorja znj. Ernst, nga shteti i Iowa-së ka mbajtur një fjalim me një përkushtim të madh për ta mbështetur Kosovën, që na ka bërë të ndihemi shumë të fuqishëm.

Ismet Beqiri theksoi se ndihet shumë i nderuar që bisedojmë me miqtë tanë dhe se takojmë njerëz me përvoja të jashtëzakonshme, që për shtetin e ri siç jemi ne, për shkëmbim përvojash, për mësim të reja është padyshim një nevojë e madhe. Po ashtu shtoi se përvoja në shumë aspekte, në aspektin e ligjshmërisë kushtetutshmërisë dhe e ndihmës në shumë shtete, do të na ndihmonte në forcimin e bashkëpunimit parlamentar dhe të shkëmbimit të përvojave. Falënderoi SHBA-të për gjithë ndihmën dhe kontributin dhënë për shtetin e Kosovës.

Adrien Wing tha se në këtë takim dëgjuam nga ju një llojllojshmëri të çështjeve që jeni të interesuar dhe ne dëshirojmë që nga ky takim të kemi një vazhdimësi për diskutim edhe me kolegët tanë në të gjitha fushat që ju përmendet.

Lidhur me bashkëpunimin në sferën e sigurisë bëri të ditur se në nëntor ka qenë një delegacion nga Kosova që të takohet me Gardën Kombëtare të Iowa-së dhe se janë shumë krenar për vazhdimësinë e këtij projekti.

Për të drejtat grave njoftoi se ka shkruar një artikull lidhur me gjenocidin dhe përdhunimet në Bosnje në vitin 1991, dhe se ky artikull është përdorur për Tribunalin e krimeve të luftës në ish-Jugosllavi.

Znj. Wing njoftoi se bashkëpunimi me studentëve tha se është jashtëzakonisht i rëndësishëm, dhe bëri të ditur se janë duke shtuar se jemi duke financuar disa studentë kosovarë në Universitetin e Iowa-së.

Në aspektin e kapaciteteve për mbështetjen e Kuvendit tha se kemi organizata të ndryshme, siç është Instituti Kombëtar Demokratik, të cilat janë të specializuara në mbështetjen e drejtpërdrejtë të stafit të

përhershëm në secilën ministri përfshirë edhe kuvendet që kanë nevojë për mbështetje në aspekt afatgjatë.

Nathan Miller në mes tjerash tha se të gjitha meritat për të arriturat e Kosovës i takojnë Kosovës. Ne jemi këtu që t'iu mbështesim dhe të marrim edhe udhëzime nga ju, se cilat çështje i konsideroni të rëndësishme për vendin tuaj.

Njoftoi se një nga fushat e ekspertizës së tij është e drejta ndërkombëtare e institucioneve ndërkombëtare të drejtësisë dhe mirëpret bashkëpunimin në këtë fushë të drejtësisë.

Po ashtu njoftoi se në emër të MPJ-së kanë hulumtuar mundësinë e Kosovës për t'u bërë anëtare e OKB-së; se janë duke i shqyrtuar rrugët që Kosova të bëhet pjesë e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë; se janë duke analizuar traktatin e Këshillit të Evropës, për të përcaktuar nëse Kosova mund të anëtarësohet, të cilat çështje tha se po mundohen që deri në fund të muajit gusht të ia vejnë në dispozicion MPJ-së.

Mbledhja përfundoi në orën 12:10.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Nënkryetari i Komisionit,

Qerim Bajrami